



Prishtinë, 13.05.2024
Kodi i ZRRE-së: V_2014_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2502_03_24** i datës 04.03.2024;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 25.03.2024.

në seancën e mbajtur më datë **13.05.2024** nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin E.R (parashtruar nga E.R) DPR – 90148105, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2502_03_24 i datës 04.03.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 04.03.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2502_03_24 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit E.R nga Komuna e Kastriotit, dhe e ka obliguar KESCO-n që ta anulojë faturat e muajve 11/12 2022 dhe 01/2023 se për këto periudha, ta faturoj sipas shpenzimeve të energjisë elektrike të periudhës 11/12 2022 dhe 01/2023, kurse për faturën e dt. 22.02.2023, ta faturojë me TL = 3 kWh dhe TU 1kWh.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- KESCO thekson se, faturimi për periudhën 11/12 2022 dhe 01/2023 është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 75153492.
- Duke e marrë parasysh që njehsori është ndërruar, pas shqyrtimit dhe verifikimit të njehsorit në QK është konstatuar gabimi në matje dhe krejt kjo si pasojë e ndërhyrjes nga jashtë.
- Korrigjimi i faturave nënkupton korrigjim të padrejtë, marrë parasysh se njehsori ka qenë i manipuluar dhe se për këtë periudhë është zbritur sasia e energjisë së faturuar, andaj, korrigjimi i faturimit për periudhën kontestuese sipas ZRrE-se do të paraqes korrigjim të dyfishtë të kWh.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 13.05.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 25.03.2024; Vendimin e DMK-së të datës 04.03.2024; Ankesën e konsumatorit në DMK/ZRrE të datës 14.11.2023; Vendimin e KESCO-s të datës 26.10.2023; Procesverbalin për pranimin e instalimit të njehsorit të dt. 08.05.2020; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 08.05.2020; Faturat e dt. 22.11.2022 dhe 20.01.2023; Ankesat e konsumatorit në KESCO; Procesverbalin e inspektimit dhe Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 24.01.2023; Transaksionet e konsumatorit; Protokollin e Verifikimit të njehsorit elektrik në QK të dt. 03.04.2023; Procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit të energjisë elektrike të dt. 15.05.2023; Procesverbalin e dt. 10.06.2023; Listat e Leximit dhe Rrjedhën e energjisë elektrike.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s është i pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 22.11.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën 11/2022, me **613 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **60.33 €**, me datë 21.12.2021 konsumatorit i është dërguar fatura për periudhën 12/2022 me **989 kWh** ose në vlerë financiare prej **95.52 €** dhe me datë 20.01.2023, konsumatorit i është dërguar fatura mujore për muajin 01/2023 me gjendje të shpenzimit prej **1,050 kWh** ose në vlerë financiare prej **101.29 €**. Me datë 22.12.2023 dhe me datë 21.01.2023 konsumatori ka parashtruar ankesa në Departamentin për Konsumator në KESCO duke i kundërshtuar faturat e muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2022 dhe të muajit janar të vitit 2023, për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 75153492. Pas ankesës së konsumatorit, me datë 24.01.2023 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe e kanë hequr nga matja njehsorin elektrik me nr. 75153492 dhe për matje e kanë vendosur njehsorin elektrik me nr. 89761653, me gjendje të shpenzimeve 000 kWh.

Bordi i ZRrE-së ka analizuar me kujdes Procesverbalin e inspektimit dhe Procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.75153492, të dt. 24.01.2023 dhe ka gjetur se, pas kërkesës së konsumatorit me datë 24.01.2023 konsumatori i është inspektuar pika matëse nga punëtorët e autorizuar të KEDS, dhe pasi që ishte vënë re që edhe pas shqyrtimit të konsumatorit, **në ekran përsëri figuronte që njehsori është duke shpenzuar energji elektrike**, i njëjti ishte larguar dhe ishte evidentuar që do të dërgohet në QK për verifikim. Në të njëjtën ditë, konsumatorit i vendoset njehsori i ri elektrik me nr. 89761653, me gjendje të shpenzimeve TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh.

Po ashtu, Bordi ka shqyrtuar edhe Procesverbalin Protokollin e Verifikimit të Njehsorit Elektrik në Qendrën Laboratorike nr. 2366 të dt. 03.04.2023, në të cilin është konstatuar se: “Njehsori elektrik nuk është në rregull, Njehsori elektrike pjesën kyçëse nuk e ka të djegur/dëmtuar, *Njehsori elektrik ka probleme me sistemet e fazave të matjes, Njehsori elektrik mund të lexohet në mënyrë softuerike, njehsori elektrik i ka bllokat shtetërore, njehsori elektrik mund të shqyrtohet dhe i njëjti dërgohet për verifikim*”. Po ashtu në procesverbal është evidentuar gabimi në matje prej **-30.32%**. Gjithashtu, në



vërejtje është evidentuar si vijon: *“Njehsori elektrik detektorin nuk e ka në vendin e vet, në bazë të leximeve softuerike shihet se është i ngacmuar me magnet nga jashtë. Njehsori elektrik në sistemin e fazës së dytë L2 regjistron energjinë elektrike edhe pa ngarkesë dhe është jashtë kufijve të për matje të energjisë elektrike, ku pa marrë parasysh ngarkesën, njehsori në këtë sistem regjistron $IL2 = 6A$. Kapakun kryesor e ka të krisur”*. Po ashtu, në këtë dokument është evidentuar që Verifikimi është bërë në prezencë të zyrtares së MINT-AMK me ID:0715.

Në të njëjtën kohë Bordi i ZRrE-se ka analizuar ka analizuar me kujdes edhe Procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit të energjisë elektrike, lidhur me njehsorin e kontestuar, punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit përfshi edhe zyrtaren e MINT-AMK kanë konstatuar këtë gjendje: *“Prej anës së jashtme komisioni ka vërejtur se detektori që tregon hapjen e kapakut kryesor nuk është në vendin e vet si dhe kapaku kryesor është i dëmtuar. Në brendi të njehsorit komisioni ka vërejtur se ka pluhur natyral si dhe për shkak të dëmtimit të jashtëm përçuesi i bobinës rrymore në sistemin e fazës së dytë (L2) është i këputur, **si pasojë e kësaj njehsori elektrik nuk regjistron energji elektrike në këtë sistem të fazës. Për shkak të dëmtimit të jashtëm tek bobinat rrymore vërehen edhe disa dëmtime tjera**”*. Pra, siç edhe mund të shihet nga vet konstatimi i këtij procesverbali, i njëjti për shkak të problemeve teknike të evidentuara, nuk ka regjistruar energji elektrike në një sistem të fazës. Andaj, në kushte normale, faturat e kontestuara do të duhej të rezultonin më të ulëta, dhe jo më të larta si në rastin konkret. Ky konstatim nga ekzaminimi i njehsorit elektrik, është edhe një dëshmi shtesë, që njehsori elektrik ka qenë më defekte, dhe si pasojë, edhe faturat e kontestuara nuk mund të paraqesin shpenzim real të konsumatorit.

Ashtu që Bordi të ketë një pasqyrë sa më të qartë të profilit të konsumatorit, ka analizuar me kujdes Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e leximit, dhe konstaton se konsumatori ka lexime të rregullta mujore. Po ashtu lexuesi i KEDS-it në asnjë rast nuk ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 75153492 është i dëmtuar në çfarëdo forme apo që dyshon në matje jo të saktë. DMK po ashtu ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike me dy njehsorët elektrik, njehsorin kontestues nr. 75153492 dhe njehsorin e ri elektrik nr. 88761653 për periudha të njëjta kohore dhe konstaton se konsumatori ka ndryshim të shpenzimit vetëm në periudhën kontestuese. Bazuar në shpenzimet e energjisë elektrike shpenzimet e konsumatorit me njehsorin kontestues janë: periudha 11/2020 është **65 kWh**, periudha 12/2020 është **18 kWh**, periudha 01/2021 është **17 kWh**, periudha 11/2021 është **23 kWh**, periudha 12/2021 është **10 kWh**, periudha 01/2022 është **34 kWh** kurse për periudhën kontestuese periudhën 11/2022 është **613 kWh**, periudhën 12/2022 është **989 kWh** dhe periudhën 01/2023 është **1,050 kWh** kurse me njehsorin e ri nr. 88761653: periudha 11/2023 është 2 kWh, periudha 12/2023 është 0 kWh dhe periudha 01/2024 është 0 kWh. Pra, nga sa mund të shihet nga ky krahasim i shpenzimeve para dhe pas periudhës kontestuese, me njehsorin e vjetër elektrik nr. 75153492, shpenzimet për periudhën e kontestuar nga konsumatori, gjegjësisht muajt nëntor, dhjetor 11/12 2022 dhe janar 01/2023 janë pakrahasimisht më të larta, se sa në muajt e njëjtë të viteve paraprake dhe të një viti më pas. Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se, edhe pasi që i është vendosur njehsori i ri, konsumatori ka shpenzim më të ulët ose të ngjashëm si në periudhat e para kontestit. Andaj, ky faturim si i tillë nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, dhe si rezultat DMK e ka obliguar KESCO-n që t'i anulojë këto fatura dhe konsumatorin ta faturojë sipas shpenzimit për muajt e njëjtë të vitit të kaluar pra periudhës 11/12/2021 dhe 01/2022. Po ashtu duke marrë për bazë se konsumatori i është larguar nga matja



njehsori nr. 75153492 me date 24.01.2023 kurse leximi i shpenzimeve per periudhën 01/2023 është bere me date 20.01.2023 atëherë edhe fatura nr. 0223291076DPR90148105 date 22.02.2023 e cila paraqet ndryshimin ne mes te datës se leximit dhe ndërrimit duhet te anulohet dhe se konsumatori per këtë periudhe duhet te faturohet me **TL=3 kWh dhe TU=1 kWh** sipas shpenzimit te periudhës janar 2022 pasi qe ne periudhën shkurt 2022 konsumatori nuk ka pasur shpenzim. Për më tepër, defektet e njehsorit të evidentuara gjatë verifikimit nga ana e jashtme, nuk janë pasqyruar në Lista të Leximit, e që një gjë e tillë do të duhej të ndodhte. Për më tepër, ka një mospërputhje në mes të konstatimeve në procesverbalin Nr. Org.02.Nr. 2366 datë 03.04.2023 dhe procesverbalin Nr. Org.02.Nr. 3527 datë 13.05.2023 sepse, në Protokollin e verifikimit të njehsorit elektrik është konstatuar se njehsori elektrik nuk ka dëmtime nga ana e jashtme, ndërkaq, në Procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit është evidentuar që, kapaku kryesor është i dëmtuar dhe se detektori që tregon hapjen e kapakut kryesor nuk është në vendin e vet. Po ashtu, edhe nga fotografitë e siguruara nga DMK, për njehsorin e kontestuar, mund të shihet vizualisht që kapaku i njehsorit është i krisur. Duhet theksuar se, në rastet kur qëllimshëm bëhet manipulimi i njehsorit, regjistrimi i energjisë elektrike është më i ulët se konsumi real i konsumatorit, e që rrjedhimisht do të rezultonte në fatura më të ulëta të energjisë elektrike. Në rastin konkret, përkundër problemeve që janë evidentuar, konsumi i konsumatorit për periudhën kontestuese është shumë më i lartë se në periudhat tjera, andaj, si të tilla këto fatura nuk paraqesin shpenzim real të konsumatorit.

Duke u bazuar në nenin 28 par.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike *“1.Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën e tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës së dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit, duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi, ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit e mundësisë së fundit”,* Bordi thekson se, DMK ka vendosur drejtë, kur ka kërkuar anulimin e këtij faturimi, duke qenë se nuk pasqyron gjendjen reale të shpenzimit të energjisë elektrike nga konsumatori.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **E.R (E.R)** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.